



## MENDIM I AVOKATIT TË POPULLIT NË LIDHJE ME PASQYRËN PERIODIKE UNIVERSALE (UPR)<sup>1</sup> TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR REPUBLIKËN E MAQEDONISË DHE SHKALLA E REKOMANDIMEVE TË ZBATUARA DERI NË VITIN 2013

**REKOMANDIMI nr. 1** – Të ratifikohet Konventa për të Drejtat e Personave me Pengesa (KPP) (Turqi, Kroaci, Argjentinë) dhe Protokolli Fakultativ i saj (Kroaci); të ratifikohet KPP dhe Protokolli Fakultativ, si dhe të harmonizohet legjislacioni i saj nacional me dispozitat e këtyre instrumenteve (Meksikë); të përshpejtohet ratifikimi i KPP (Azerbajxhan); të nis konsultimi nacional për përgatitjen e ratifikimit të KPP (Mbretëria e Bashkuar).

**Statusi: pranohet**

**AP:** Zbatimi në praktikë i Konventës për të Drejtat e Personave me Pengesa është vështirësuar. Fëmijët me nevoja të veçanta, me vështirësi e realizojnë të drejtën e arsimit në paralelet e rregullta (arsimi inkluziv), mes tjerash për shkak të numrit të vogël të defektologëve nëpër shkolla dhe për shkak të presioneve nga ana e prindërve, fëmijët e të cilëve nuk janë me nevoja të veçanta.

Personat me nevoja të veçanta edhe më tej nuk e realizojnë plotësisht të drejtën e punësimit, si në Shoqëritë mbrojtëse tregtare, ashtu edhe në administratën publike dhe shtetërore.

Në numrin më të madh të stacioneve policore, Avokati i Popullit vuri në dukje se nuk janë vendosur platforma të pjerrëta edhe atë as në hyrje të stacioneve policore e as në ambientet për ndalim. Shqetëson fakti se nëpër burgje vendosen persona me invaliditet, për të cilët nuk sigurohen kushte përkatëse. Trajtimin e këtyre dhe mosndërmarrjen e masave përkatëse parandaluese, MPN-ja e konsideron si trajtim skajshëm nënçmues dhe jonjerëzor dhe i njëjti drejtpërsëdrejti është në kundërshtim me obligimet të cilat burojnë nga disa akte ndërkombëtare: Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe në veçanti Konventën për të Drejtat e Personave me Pengesa: “Vendet nënshkruese sigurojnë se, në qoftë se personat me invaliditet privohen nga liria me procedurë, ata, mbi bazë të barabartë me të tjerët, kanë të drejtë për garanci, në përputhje me të drejtat ndërkombëtare të njeriut, si dhe trajtohen në përputhje me qëllimet dhe parimet e kësaj Konvente.”

**REKOMANDIMI nr. 2** – Të ratifikohet Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të gjithë Personave nga zhdukja e detyrueshme (Kroaci, Argjentinë) dhe të pranohet kompetenca e Komitetit për Zhdukje të Detyrueshme (Argjentinë); të ratifikohet kjo Konventë sa më parë që të jetë e mundur (Francë).

**Statusi: pranohet**

**REKOMANDIMI nr. 3** – Të ratifikohet Protokolli Fakultativ i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore dhe Konventa Ndërkombëtare për Mbrojtjen e të Gjithë Migrantëve – punonjëse dhe anëtarë të familjeve të tyre (Argjentinë).

**Statusi: pranohet**

**REKOMANDIMI nr. 4** – Të zbatohet pasqyrë vëllimore për harmonizimin e së drejtës vendase me dispozitat e Konventës për të Drejtat e Fëmijëve (Poloni); të vazhdojë harmonizimi i legjislacionit me standardet ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut (Ukrainë).

**Statusi: pranohet**

---

<sup>1</sup> UPR është mekanizëm përmes së cilit Shtetet, në kuadër të Këshillit për të Drejtat e Njeriut të KB-së, në çdo 4,5 vjet, e analizojnë bashkërisht gjendjen me të drejtat e njeriut në secilin prej tyre

**REKOMANDIMI nr. 5 – Të merret parasysh ndërmarrja e masave përkatëse në mënyrë që të sigurohet se Avokati i Popullit është dakord me Parimet e Parisit ose eventualisht të parashikohet themelimi i një institucioni për të drejtat e njeriut konform këtyre parimeve (Alzhir); të themelohet institucion për të drejtat e njeriut, i akredituar nga Komiteti Koordinues Ndërkombëtar për institucione nacionale për të drejtat e njeriut (Brazil); të shqyrtohet roli i mandatit të zyrës së Avokatit të Popullit, veçanërisht në fushën e antidiskriminimit dhe keqpërdorimeve nga ana e policisë dhe të garantohet financimi i mjaftueshëm i tij, siç është sugjeruar nga Komisariati i Lartë për të Drejtat e Njeriut të Këshillit të Evropës (Poloni); të ndërmerren të gjitha masat e domosdoshme në mënyrë që të sigurohet se zyra e Avokatit të Popullit është harmonizuar me atë që është përcaktuar në Parimet e Parisit dhe se është plotësisht i pavarur nga aspekti i financimit (Argjentinë); të sigurohen mjete të mjaftueshme për funksionimin e mekanizmave parandalues nacional pas ratifikimit të Protokollit Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Trajtitit Brutal, Jonjerëzor, Nënçmues dhe Ndëshkues (Republika Çeke).**

***Statusi: pranohet***

**AP:** Avokati i Popullit fitoi statusin B, si Institucion nacional për të drejtat e njeriut me rekomandimet të cilat duhet t'i plotësojë. Është dërguar Mendim adresuar Trupit Ndërkombëtar për të Drejtat e Njeriut për nevojën e ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit për AP, me të cilat do të përfshihen Parimet e Parisit (përfshirja e promovimit, sigurimit të pluralizmit dhe pavarësisë më të madhe). Në Ligjin për Avokatin e Popullit akoma nuk është përfshirë promovimi i të drejtave të njeriut, e që është njëri nga Parimet e Parisit dhe kusht për fitimin e statusit A. Njëkohësisht, është e nevojshme që Ligji të harmonizohet me Protokollin Fakultativ ndaj Konventës Kundër Torturës. AP duhet të fitojë pavarësi më të madhe, me qëllim të përforcimit të besimit nga ana e qytetarëve, përmes ndarjes së shërbimit profesional të AP-së nga nëpunësit shtetërorë.

Me ndryshimet e Ligjit të AP në vitin 2009, u formua Seksioni i posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi dhe përfaqësimin e drejtë dhe adekuat, si dhe Seksioni për të drejtat e fëmijëve dhe Mekanizmi Parandalues Nacional. Me hyrjen në fuqi të ndryshimeve të Ligjit për Avokatin e Popullit, u miratua Rregullorja për mënyrën e kryerjes së parandalimit të torturës dhe Metodologjia për kryerjen e parandalimit të torturës.

Për vitin 2013 buxheti i MPN-së kap shumën prej 520.000,00 denarë, me të cilën sigurohet qasje multidisiplinare me angazhimin e ekspertizës së jashtme. MPN-ja përbëhet nga dy këshilltarë dhe nevojitet rritje dhe përforcim i resurseve njerëzore, me qëllim të plotësimit të mandatit të parashikuar me OPKAT-in.

**REKOMANDIMI nr. 6 – Vëmendje më e madhe t'i kushtohet implementimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe të përbushen prioritetet strategjike të cilat burojnë nga e njëjta (Zvicër).**

***Statusi: pranohet***

**REKOMANDIMI nr. 7 – Të merret parasysh mundësia e zbatimit të evaluimit afatmesëm të Plan Veprimit për të drejtat e fëmijës (Marok).**

***Statusi: pranohet***

**REKOMANDIMI nr. 8 – Të miratohet plan gjithëpërfshirës nacional për regjistrimin e statusit civil dhe të drejtën për identitet, i cili përfshin fushata për ngritjen e vetëdijes tek prindërit, kujdestarët dhe personat përgjegjës, të cilët do të ndihmojnë në përsheptimin e regjistrimit të lindjeve (Argjentinë).**

***Statusi: pranohet***

**REKOMANDIMI nr. 9 – Të sigurohet zbatim i menjëhershëm i rekomandimeve të formuluar nga Komiteti Kundër Torturës në vitin 2008, në kontekst të gjendjes së përgjithshme të sistemit të burgjeve (Itali).**

***Statusi: pranohet***

**AP:** MPN-ja, për periudhën kohore prill 2011 – qershor 2013, realizoi 50 vizita të paparalajmëruara në vendet e privimit nga liria, si dhe 15 vizita për ri-kontroll. Si gjendje shqetësuese në institucionet ndëshkuese-korrektuese, MPN-ja e konstatoi zbatimin e pjesshëm të dispozitave të Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, si dhe mbipopullimin, me ç'rast nuk respektohet maksimumi ligjor për vendosjen e 5 personave në një dhomë kolektive, njëkohësisht si johumane dhe përcmuese u vlerësuan kushtet dhe vendosja në qelitë e izolimit. Personat e vendosur në ambientet e paraburgimit qëndrojnë në standarde minimale, ndërsa pjesën më të madhe të kohës e kalojnë të mbyllur edhe nga 23 orë në ditë. Me kërkesë të MPN-së, qelitë për izolim nuk shfrytëzohen në burgun për të mitur Ohër, të cilat ishin në gjendje tejte të shkatërruara, ndërkaq është realizuar edhe rinovimi i dy reparteve në ENK "Idrizovë". Lëshime ka edhe në udhëheqjen e mbrojtjes shëndetësore nëpër institucionet ndëshkuese-korrektuese, me ç'rast nuk respektohen tërësisht dispozitat e Ligjit, qasja dhe kualiteti i shërbimeve nuk kënaq dhe jo gjithmonë vendoset raporti mjek-pacient. Me rekomandimin se në burgje duhet të ketë mjek të punësuar me marrëdhënie të rregullt pune, si dhe rritje të numrit të të punësuarve në sektorët për sigurim, si dhe sektorët për risocializim, është dhënë përgjigjja se e gjithë kjo varet nga sigurimi i financave, përkatësisht nga dhënia e pëlqimit nga ana e Ministrisë së Financave. Në burgjet më të vegjël, mundësohen kushtet dhe realizimi i të drejtave, mirëpo një gjë e tillë vështirë realizohet në burgjet e mëdha, si dhe në paraburgimin Shkup, ku realisht ekziston mungesë e hapësirës, por edhe e mjeteve financiare. Personat e dënuar, në të shumtën e rasteve, ankohen për ushqimin, mbrojtjen shëndetësore, por edhe për sjelljen e personelit të burgut. Gjithashtu, edhe më tej ngelet e hapur çështja e realizimit të së drejtës për arsim, ndërsa shkalla e angazhimit me punë është në nivel të ulët dhe të pakënaqshëm. Enti Edukues-Korrektues nuk i plotëson standardet e nevojshme ndërkombëtare, personat vendosen në kushte joadekuate dhe për të njëjtët nuk sigurohet arsimimi.

Gjatë punës sipas lëndëve, AP konstatoi se ka raste të klasifikimit selektiv të personave të dënuar, ndërkohë që vuri në pah edhe jokonsekuenca dhe parregullsi të caktuara në Rregulloren për sistematizim, klasifikim dhe transferim të personave të dënuar. Sjellja joprofesionale dhe angazhimi i pamjaftueshëm i shërbimeve të sigurimit rezultoi me situata konfliktuozë midis personave të dënuar, me çka u vu në pikëpyetje siguria personale e personave të dënuar dhe siguria e institucioneve. Procesi riedukues edhe më tej nuk e plotëson funksionin e tij të mirëfilltë, ndërsa ekipimi i pamjaftueshëm i shërbimeve dhe mungesa e mjeteve financiare edhe më tej janë problem serioz me të cilin ballafaqohen këto institucione. Shqetëson fakti se edhe më tutje evidentohen raste të torturës.

Numri i përgjithshëm i parashtrësive për institucionet ndëshkuese-korrektuese dhe edukuese-korrektuese: 2008 - 55, 2009-347, 2010-395, 2011-352, 2012-278,

nga të cilat për torturë dhe forma tjera të trajtimit johuman në burgje janë: 2008-1, 2009-7, 2010-21, 2011-16 dhe 2012- 26.

**REKOMANDIMI nr. 10 – Të vazhdohet me përpjekjet për harmonizimin e legjislacionit nacional me instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut (Nikaragua).**

***Statusi: pranohet***

**AP:** Nevojitet harmonizimi i Ligjit për Avokatin e Popullit me Protokollin Fakultativ të Konventës Kundër Torturës dhe Llojeve tjera të Trajtimeve Brutale, Johumane, Nënçmuese dhe Ndëshkuese.

**REKOMANDIMI nr. 11 – Të vazhdohet me dërgimin e raporteve drejtuar trupave të ndryshëm, të cilët e ndjekin zbatimin e konventave, me qëllim që të përmbushen obligimet përmes implementimit të rekomandimeve nga këta komitete (Nikaragua).**

***Statusi: pranohet***

**AP:** MPN-ja, raportin e vet ia dërgon Nënkomitetit për Parandalimin e Torturës (është dërguar për vitin 2011, ndërsa për vitin 2012 do të dërgohet pasi të përfundojë përkthimi).

**REKOMANDIMI nr. 12 – Të vazhdohet me politikën e hapur ndaj procedurave speciale të Këshillit për të Drejtat e Njeriut (Meksikë)**

***Statusi: pranohet***

**REKOMANDIMI nr. 13 – Të ndërmerren masa të mëtutjeshme konkrete për përforcimin e legjislacionit relevant për luftë kundër diskriminimit (Republika Çeke); të organizohen fushata për ngritjen e vetëdijes për luftë kundër të gjitha formave të diskriminimit, përfshirë edhe ato që bazohen mbi bazë të: gjinisë, përkatësisë etnike, orientimit seksual ose identitetit gjinor (Republika Çeke); të miratohet legjislacion gjithëpërfshirës kundër diskriminimit (Kroaci); të përshpejtohet procesi i formulimit të kornizës ligjore kundër diskriminimit dhe të përforcohet roli i strukturave administrative të cilat janë formuar për ndalimin e çdo lloj diskriminimi (Shqipëri); të miratohet dhe implementohet Ligji për mbrojtje nga diskriminimi dhe të sigurohet qasje efektive ndaj mjeteve juridike gjyqësore për viktimat e diskriminimit (Kanada).**

***Statusi: pranohet***

**AP:** Në lidhje me punën sipas lëndëve, Avokati i Popullit konstatoi se diskriminimi më shumë është prezentë në fushën e marrëdhënieve të punës, ndërsa si bazë më e shpeshtë e diskriminimit është përkatësia etnike.

Në vitin 2012, Avokati i Popullit ndërmori një sërë aktivitete për promovimin dhe mbrojtjen e qytetarëve nga diskriminimi. Në këtë drejtim, Institucioni i realizoi projektet si vijojnë: shfaqjen teatrale: “Të njëjtë në mënyrë të ndryshme”, e cila u shfaq disa herë, ndërkaq në vete i përmbante format më të shpeshta të diskriminimit të mundshëm; në nivel nacional e realizoi emisionin e drejtpërdrejtë kontaktues kushtuar temës së diskriminimit, me ç’rast qytetarët patën mundësi të informohen për format e mundshme të fenomenit të diskriminimit, si dhe drejtpërdrejtë të parashtronjë pyetje; publikoi broshura me titull: “Në mbrojtje nga diskriminimi”, e cila përmban përshkrimin e nocioneve dhe formave kryesore për identifikimin e diskriminimit dhe mekanizmat për mbrojtje nga diskriminimi, si dhe standardet ndërkombëtare dhe normat vendase për mbrojtje nga diskriminimi, gjithashtu publikoi edhe fletëpalosje të posaçme për mbrojtje nga diskriminimi, të përkthyer në shtatë gjuhë.

Gjatë viteve të kaluar, në më shumë qytete të Republikës së Maqedonisë, u organizuan tryeza të rrumbullakëta në të cilat u promovua roli i Seksionit për mbrojtje nga diskriminimi, ndërsa njëkohësisht në takime u prezantuan standardet dhe procedurat për mbrojtje nga diskriminimi dhe zbatimi i parimit të përfaqësimit të drejtë dhe adekuat. Këto tryeza të rrumbullakëta fillimisht u dedikuan për të punësuarit e administratës publike, ku punojnë dhe i zbatojnë ligjet dhe normat e tjera. Gjithashtu, vlen të përmendet se ka filluar edhe komunikimi me Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, me qëllim të bashkërendimit të lëndëve nga kjo fushë.

**REKOMANDIMI nr. 14 – Të inkorporohen masa adekuate me qëllim të promovimit të kohezionit të të gjitha grupeve etnike (Greqi)**

***Statusi: pranohet***

**REKOMANDIMI nr. 15 – Të vazhdohet me përpjekjet për avancimin e të drejtave të grupeve vulnerable (Kazakistan)**

***Statusi: pranohet***

**REKOMANDIMI nr. 16 – Të ndërmerren masa sistematike për promovimin në praktikë të barazisë gjinore, mes tjerash, përmes rritjes së pjesëmarrjes së grave në polici (Greqi); të promovohet pjesëmarrja dhe përfaqësimi i grave në sektorin qeveritar dhe privat (Brazil); të intensifikohen përpjekjet për përshejtimin e pjesëmarrjes së barabartë të grave në të gjitha nivelet dhe fushat e jetës publike (Norvegji); të përshejtohen përpjekjet për sigurimin e qasjes në arsim, shëndetësi, punësim dhe pjesëmarrje në jetën publike politike të grave, veçanërisht në vendet rurale dhe të grave të minoriteteve etnike (Malajzi).**

**Statusi: pranohet**

**AP:** Avokati i Popullit, në kuadër të autorizimeve kushtetuese dhe ligjore, përveç tjerash, është kompetent të ndërmerr masa për mbrojtjen e parimit të barazisë midis gjinive, me ç'rast krahas veprimit sipas parashtresave individuale, në përputhje me nenin 28 dhe 29 të Ligjit për Avokatin e Popullit, është kompetent edhe për ndjekjen e gjendjeve në lidhje me sigurimin e respektimit të këtij parimi.

Avokati i Popullit, në lidhje me barazinë gjinore, vëmendje të veçantë u kushtoi të dhënave që kanë të bëjnë me numrin e përgjithshëm të të punësuarve mbi bazë të gjinisë, si dhe strukturës gjinore sa u përket vendeve udhëheqëse të punës. Të dhënat tregojnë se, nga numri i përgjithshëm i të punësuarve nëpër institucione, 56 771 janë meshkuj ose 52,94%, ndërsa 50 467 janë femra ose 47,06%. Në vendet udhëheqëse të punës, përfaqësimi i meshkujve është 55,22%, ndërsa i femrave është 44,78%, ndërsa në vendet joudhëheqëse të punës meshkujt përfaqësohen me 52,71%, ndërsa përfaqësimi i gjinisë femërore është 47,29%.

**REKOMANDIMI nr. 17 – Të dyfishohen përpjekjet në fushën e avancimit të femrave dhe barazisë efektive gjinore në fuqinë e punës, si dhe në sferën shoqërore (Spanjë); të miratohen të gjitha masat që janë të domosdoshme për sigurimin e barazisë midis meshkujve dhe femrave në të gjitha fushat, të cilat janë relevante për Konventën për Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit Kundër Grave (Francë).**

**Statusi: pranohet**

**HP:** Me qëllim të krijimit të kushteve për barazi midis qytetarëve, sidomos sa i përket barazisë gjinore dhe ndalimit të diskriminimit mbi bazë të gjinisë, me Ligjin për mundësi të barabarta të femrave dhe meshkujve janë përcaktuar masat themelore dhe të posaçme për vendosjen e mundësive të barabarta dhe trajtimin e barabartë të femrave dhe meshkujve në të gjitha sferat e jetës shoqërore, me ç'rast ndalohet diskriminimi mbi bazë të gjinisë në sektorin publik dhe privat, veç tjerash edhe në fushën e punësimit.

Në përputhje me nenin 15 të këtij Ligji, Avokati i Popullit është i autorizuar që, në kuadër të kompetencës së përcaktuar ligjore të tij, të kujdeset për realizimin e parimit të mundësive të barabarta të femrave dhe meshkujve dhe të sigurojë mbrojtje në rastet kur dikujt i hiqet ose kufizohet e drejta nga organet dhe organizatat para të cilave është kompetent të veprojnë. Gjithashtu, sipas Plan Veprimit Nacional për Barazinë Gjinore për vitet 2007-2012 për realizimin e qëllimit strategjik: "Të drejtat e njeriut dhe gruaja" institucion përgjegjës është edhe Avokati i Popullit.

**REKOMANDIMI nr. 18 – (a) Të sigurohet se orientimi seksual dhe identiteti seksual në mënyrë eksplicite janë përfshirë në ligjet dhe programet antidiskriminuese (Suedi); dhe se orientimi seksual dhe identiteti gjinor në mënyrë eksplicite janë përfshirë përmes ligjeve dhe programeve antidiskriminuese (Danimarkë); (b) të sigurohet që partnerët e gjinisë së njëjtë të kenë të drejta dhe përgjegjësi të barabarta, sikurse edhe partnerët e gjinive të ndryshme (Danimarkë).**

**Statusi: a) pranohet b) refuzohet**

**REKOMANDIMI nr. 19 – Të zbatohet reformë gjithëpërfshirëse e sistemit ndëshkues-korrektues, e cila do t'i adresojë shqetësimet e shprehura nga ana e vëzhguesve ndërkombëtarë dhe sidomos nga Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Jonjerëzor dhe Nënçmues (Kanada).**

**Statusi: pranohet**

**REKOMANDIMI nr. 20** – Të inkurajohen institucionet përkatëse në drejtim të ndërmarrjes së aktiviteteve të mëtutjeshme për luftimin e dhunës mbi gratë (Kroaci); të implementohen masa për mbrojtjen dhe ndëshkimin e dhunës mbi gratë rome, në atë mënyrë që të jenë të afta t'i gëzojnë të drejtat e tyre pa paragjykime (Japoni); të zvogëlohen kërkesat rigoroze për dëshmi për dhunën në familje, në atë mënyrë që ligji ekzistues i cili e ndëshkon dhunën në familje më lehtë të mund të zbatohet në praktikë (Holandë); të implementohen masa për identifikimin e hershëm dhe mbrojtjen nga dhuna në familje mbi gratë dhe fëmijët, përfshirë edhe abuzimin seksual ose keqtrajtimin (Holandë); të vazhdojë bashkëpunimi me shoqërinë civile me qëllim të ngritjes së vetëdijes dhe të sigurohet mbrojtje dhe mbështetje për viktimat (Austri); të miratohet politikë vendimtare penale për ndjekjen dhe ndëshkimin e kryerësve të dhunës kundër grave, si dhe të praktikohet politikë parandaluese në mënyrë që të rritet ndjeshmëria e mbarë shoqërisë në lidhje me këtë çështje (Francë).

**Statusi: pranohet**

**REKOMANDIMI nr. 21** – Të bëhet çdo gjë, në kuadër të mundësive, në mënyrë që të përmirësohen kushtet në paraburgim dhe të ndiqen të gjithë kryerësit e keqpërdorimeve (Zvicër); tërësisht të adresohen të gjitha pyetjet e dhëna në Raportin e Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit Jonjerëzor dhe Nënçmues të datës 4 nëntor (Holandë).

**Statusi: pranohet**

**AP:** Gjatë vitit 2012, MPN-ja realizoi vizitë edhe në disa reparte të paraburgimit, në përbërje të institucioneve ndëshkuese-korrektuese të llojit gjysmë të hapur. Nga vizita, Avokati i Popullit – MPN konstatoi se në praktikë nuk respektohen dhe nuk zbatohen në tërësi standardet ndërkombëtare dhe vendase, në pjesën e kushteve materiale, si dhe identifikoi një numër të madh të mangësive dhe parregullsive. Mbipopullimi ngelet një nga problemet më të mëdha në repartet e paraburgimit. Personat e paraburgosur dhe personat e vendosur në qeli-izolim, ushqimin e marrin dhe e konsumojnë në ambientet e njëjtë në të cilët janë vendosur, ndërsa në të cilët higjiena shpeshherë është në nivel të ulët, gjë që mund të paraqes rrezik potencial për shëndetin e tyre. MPN-ja konsideron se praktika e këtillë është poshtëruese, duke i pasur parasysht kushtet e pavolitshme dhe të pa-kënaqshme materiale në këto ambiente.

MPN-ja, si problem më të madh e potencon hapësirën e kufizuar dhe tejet restriktive të lëvizjes së personave të cilët vuajnë masën e paraburgimit. Përkatësisht, këta persona, pjesën më të madhe të ditës dhe natës e kalojnë në ambientet e tyre të gjumit (madje nga 22 orë në ditë), ndërsa vetëm një ditë qëndrojnë nga dy orë jashtë ambienteve të tyre. Qëndrimi jashtë, në ambient të hapur, për më pak se 2 orë është në kundërshtim me dispozitat ligjore, të cilat parashikojë se personave të paraburgosur duhet t'u sigurohet lëvizje në ambient të hapur më së paku dy orë në ditë. Sugjerimet e këtilla, Avokati i Popullit-MPN ua dërgoi drejtorive të disa institucioneve ndëshkuese-korrektuese, me ç'rast i përkujtoi se e drejta për qëndrim në ambient të hapur duhet të zbatohet çdoherë dhe domosdoshmërisht, në përputhje me dispozitat e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve, ndërsa kufizimi në një orë për qëndrim dhe shëtitje në ambient të hapur është përcaktuar vetëm për dënimin disiplinor dërgim në dhomë izolimi, por jo edhe për kategoritë e tjera të personave të privuar nga liria.

Personat e paraburgosur shumë rrallë ose fare nuk vizitohen nga ana e gjyqtarëve, kryetari i gjykatës themelore ose ndonjë gjyqtari tjetër, gjë që është në përputhje me obligimet të cilat rezultojnë nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve dhe Ligji për procedurë penale.

Në praktikë, Rendi i ri i shtëpisë për personat e paraburgosur zbatohet me vështirësi për shkak të mundësive të kufizuara të reparteve të paraburgimit.

**REKOMANDIMI nr. 22** – Të zhvillohet ndihma juridike dhe mekanizmat mbrojtës për viktimat e dhunës në familje (Spanjë)

**Statusi: pranohet**

**REKOMANDIMI nr. 23** – Të miratohet dhe të implementohet legjislacion, i cili do ta ndalojë ndëshkimin trupor mbi çfarëdo baze dhe kjo të mbështetet me fushata për ngritjen e vetëdijes publike (Austri); të miratohen masa përkatëse, konsekuente me standardet ndërkombëtare, për shmangien e ndëshkimit trupor mbi fëmijët nga të gjitha fushat dhe të zbatohet edukimi dhe fushata për ngritjen e vetëdijes publike në shkolla dhe në përgjithësi në shoqëri (Argjentinë).

*Statusi: pranohet*

**REKOMANDIMI nr. 24** – Të rritet niveli i mbrojtjes së minoriteteve, veçanërisht i atyre që janë në situatë të mungesës së mbrojtjes dhe që janë jashtë sistemit të detyrueshëm arsimor (Spanjë)

*Statusi: pranohet*

**REKOMANDIMI nr. 25** – Të vazhdojnë dhe të shtohen angazhimet për luftë të plotë kundër trafikimit me njerëz dhe prostitucionit dhe të vazhdojnë përpjekjet për dhënien ndihmë grave të cilat kanë qenë viktime të trafikimit me njerëz (Suedi); të përshpejtohen masat për luftë kundër prostitucionit dhe trafikimit me gra e vajza, përfshirë edhe realizimin e më shumë fushatave nacionale për ngritjen e vetëdijes publike dhe realizimin e trajnimeve për kryerësit, repartin e migracionit dhe policisë kufitare (Malajzi).

*Statusi: pranohet*

**REKOMANDIMI nr. 26** – Të përforcohet pavarësia dhe kapaciteti i përgjithshëm i sistemit të jurisprudencës (Slloveni)

*Statusi: pranohet*

**REKOMANDIMI nr. 27** – Të vazhdohet që kuadrit policor, kuadrit të burgut dhe atij gjyqësor t'u sigurohen trajnime praktike - trajnime të orientuara dhe edukim për të drejtat e njeriut (Republika Çeke)

*Statusi: pranohet*

**AP:** Avokati i Popullit vazhdoi me trajnime dhe tryeza të rrumbullakëta, sidomos në kontekst të policisë dhe personelit të burgut. Në Manastir, Tetovë dhe Shtip u mbajtën tryeza të rrumbullakëta me temë: "Avokati i Popullit – Mekanizëm Parandalues Nacional". Në to morën pjesë përfaqësues nga: stacionet policore, sektorët e punëve të brendshme, institucionet ndëshkuese-korrektuese, entet speciale dhe spitalet psikiatrike, pushteti lokal, universitetet shtetërore dhe nga sektori civil.

MPN-ja realizoi 2 trajnime në Qendrën e MPB: Për rolin e AP-së dhe për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe për Mekanizmin Parandalues Nacional (16 dhe 25.04.2013).

**REKOMANDIMI nr. 28** – Të inkorporohen mekanizma për kontroll të brendshëm të gardianëve të burgut në rregullat dhe rregulloret e burgjeve dhe qendrat e paraburgimit (Holandë); të themelohet mekanizëm efektiv dhe i pavarur për monitimin e policisë (Danimarkë)

*Statusi: pranohet*

**AP:** Me kërkesë të MPN-së u realizuan 5 monitorime profesionale dhe u veprua konform një pjese të rekomandimeve të dhëna.

Gjatë vizitës së INK në RM u konstatua se Komisioni për Mbikëqyrje i INK nuk funksionon dhe deri më tani nuk ka realizuar asnjë vizitë. Gjatë realizimit të vizitave, MPN-ja pati bashkëpunim të kënaqshëm dhe konstruktiv me personat zyrtarë dhe realizoi këqyrje papengesë në të gjitha ambientet, objektet dhe instalimet, sipas zgjedhjes së vet, si dhe zhvilloi bisedë me persona të privuar nga liria sipas përzgjedhjes së vet, pa mbikëqyrje dhe pa dëshmitarë. Në asnjë rast, ekipit të MPN-së nuk iu kufizua hapësira e lëvizjes, e as liria e përzgjedhjes së personave për bisedë.

**REKOMANDIMI nr. 29 – Të sigurohet se të dhënat për keqtrajtim nga ana e nëpunësve, të cilët e zbatojnë ligjin, janë hetuar me kohë, tërësisht dhe në mënyrë të paanshme dhe se përgjegjësitë janë ndëshkuar (Danimarkë)**

***Statusi: pranohet***

**AP:** Nga ana e MPN-së u konstatua zbatim joefikas i hetimit nga drejtoria e burgut gjatë ekzistimit të dyshimit për sulm fizik ose dhunë (për burgjet). MPN-ja vendosi edhe komunikim papengesë me MPB përmes mbajtjes së rregullt të takimeve të punës.

Në vitin 2011, nga ana e AP-së është paraqitur: 1) kallëzim penal kundër 5 personave zyrtarë të Burgut Tetovë – është paraqitur kërkesë për përcaktimin e përgjegjësisë penale pranë PTHP Tetovë; 2) kallëzim penal për 2 persona zyrtarë në Shkup – PTHP Shkup ka hequr dorë nga ndjekja; 3) Kërkesë për përcaktimin e përgjegjësisë disiplinore për një person zyrtar në Shkup, i njëjti është ndëshkuar dhe i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Në vitin 2012 1) Kallëzim penal për 4 persona zyrtarë në Burgun Manastir, është paraqitur kërkesë për përcaktimin e përgjegjësisë penale pranë PTHP Manastir, nga ana e Avokatit të Popullit dhe është paraqitur kërkesë për zbatimin e hetimit nga ana e Prokurorisë Publike dhe 2) sipas informatës së dërguar nga AP deri te ministri i Drejtësisë është hapur procedurë për përgjegjësi disiplinore për 4 persona zyrtarë të Burgut Shkup dhe të njëjtët janë ndëshkuar me zvogëlim të pagës.

**REKOMANDIMI nr. 30 – Të vazhdojnë reformat në sistemin e burgjeve dhe të përmirësohen kushtet në institucionet ndëshkuese-korrektuese (Azerbajxhan); të vazhdojnë dhe të përforcohen përpjekjet rrjedhëse për sigurimin e mirëqenies së personave të burgosur dhe të paraburgosur, në përputhje me Konventën Kundër Torturës dhe standardet e tjera ndërkombëtare (Suedi); të përshpejtohen reformat në sistemin e burgjeve dhe të merret parasysh inkorporimi i programeve për risocializim në mënyrë që të sigurohet riintegrimi i të burgosurve në bashkësi dhe të zvogëlohet rreziku për shkeljen e sërishme të ligjit nga ana e tyre (Mbretëria e Bashkuar)**

***Statusi: pranohet***

**AP:** MPN-ja konstatoi se Programi vjetor i Qeverisë së RM-së për rikonstrukcionin e INK-ve dhe EEK-së nuk është zbatuar konform parashikimeve, më saktë një pjesë e aktiviteteve janë bartur për realizim në vitin 2013. Gjendja me kushtet materiale në repartet e pranimit të institucioneve ndëshkuese-korrektuese është e ndryshme dhe varet nga madhësia e institucionit dhe kapacitetet hapësinore. Në praktikë ekzistojnë raste kur reparti i pranimit nuk është fare i ndarë nga repartet e tjerë ku vendosen personat e dënuar, ndërsa në disa INK ky repart paraqet vetëm një ambient për vendosje, zakonisht në përbërje të repartit gjysmë të hapur dhe/ose repartit të hapur të pjesës së burgut, ku janë të vendosur personat e dënuar. Është vërejtur se kushtet materiale në repartet e mbyllur janë më të këqija, krahasuar me vendosjen në repartet gjysmë të hapur dhe të hapur, me përjashtim të INK "Idrizovë"-Shkup ku gjendja, që ka të bëjë me kushtet materiale në repartet e tjerë, shkakton shqetësim të njëjtë ose më të madh. Shkalla e angazhimit me punë në institucionet ndëshkuese-korrektuese në Republikën e Maqedonisë është në nivel relativisht të ulët. Duke e pasur parasysh qëllimin e risocializimit, MPN-ja konstatoi se vetëm personave të dënuar me regjim të trajtimit të butë (trajtim gjysmë i hapur ose i hapur) u sigurohet që përmes punës të fitojnë dhe t'i zhvillojnë shprehje të punës dhe të pajisen me shkathtësi profesionale për punë në liri.

Në pjesën më të madhe të INK-ve, të cilat gjatë vitit 2012 i vizitoi MPN-ja, personat e dënuar dhe personat të cilët vuajnë masën e paraburgimit, ndërkaq me të cilët u zhvillua bisedë, nuk u ankuan në lidhje me torturën ose llojeve tjera të trajtimit brutal, jonjerëzor, nënçmues ose ndëshkues nga ana e shërbimeve të institucionit. Në ato INK, ku kishte ankesa nga personat e dënuar, MPN-ja konstatoi se në mënyrë pamjaftueshëm efikase zbatohen hetimet edhe gjatë dyshimit më të vogël të dhunës ose keqtrajtit fizik.



**REKOMANDIMI nr. 31 – Të vazhdohet me angazhimet për implementimin e Ligjit për ekzekutimin e sanksioneve (Vatikan).**

**Statusi: pranohet**

**AP:** Nga vizitat e realizuara gjatë vitit 2012 në INK dhe EEK, Mekanizmi Parandalues Nacional konstatoi se kushtet materiale në këto institucione nuk i plotësojnë apo i plotësojnë vetëm pjesërisht standardet vendase dhe ndërkombëtare, ndërkaq në praktikë Ligji për ekzekutimin e sanksioneve, aktet nënligjore dhe protokollet nuk zbatohen tërësisht dhe me përpikëri.

**REKOMANDIMI nr. 32 – Të sigurohen mjete financiare dhe resurse njerëzore për Ministrinë e Punëve të Brendshme në mënyrë që ta konfiskojë sasinë e madhe të armëve tek banorët civil dhe të sigurohet gjendje më e mirë e sigurisë dhe kushteve në burgje (Spanjë).**

**Statusi: pranohet**

**REKOMANDIMI nr. 33 – Të analizohen kushtet nëpër burgje, në vendet e paraburgimit dhe institucionet e tjera të përcaktuara me OPKAT, me qëllim që të sigurohet harmonizimi i tyre i plotë me standardet ndërkombëtare, sidomos rreth përdorimit të mjeteve për lidhje dhe sa u përket personave të mitur (Republika Çeke).**

**Statusi: pranohet**

**AP:** Ligji për drejtësinë e të miturve kërkon ambient të veçantë për ndalimin e personave të mitur, por MPN-ja në asnjë stacion policor nuk konstatoi se ekziston një ambient i tillë, ndërkaq vetëm në dy stacione policore ka ambiente të veçanta për bisedë me persona të mitur.

Gjatë vizitës së EEK, MPN-ja pranoi ankesa për dhunë mbi personat e mitur nga ana e shërbimit të sigurimit, ndërsa ankesa të këtilla nuk pati në burgun për të mitur. Për ankesat janë njoftuar drejtoria e EEK-së, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve, si dhe është hapur lëndë tek Avokati i Popullit. Njëkohësisht, me kërkesë të DES-it, në EEK Tetovë është vendosur sënduk për parashtrimin e parashtrësave drejtuar Avokatit të Popullit.

Në përputhje me Ligjin për ekzekutimin e sanksioneve, personat e dënuar e vuajnë dënimin burg për të mitur në institucion të veçantë për të mitur. Përcaktimi ynë ligjor dhe konfirmimi i dënimit burg për të mitur fillon nga momenti kur është kryer vepra dhe jo kur zbatohet dënimi, me ç'rast në institucionin e veçantë për të mitur, ku kryhet vuajta e dënimit me burg e të miturit, vendosen edhe persona deri në moshën 23 vjeçare, të cilët janë persona të ri të moshës madhore dhe nuk bëjnë pjesë në kategorinë e personave të mitur. Në këtë pjesë, MPN-ja dha rekomandim që të respektohen rregullat minimale standarde të Kombeve të Bashkuara për zbatimin e procedurave gjyqësore ndaj të miturve, me ç'rast theksohet se *“Të miturit e vendosur në burg duhet të qëndrojnë ndaras nga personat e rriturit, në institucione të veçanta ose në pjesë të veçanta të institucionit në të cilin janë vendosur të burgosurit e rriturit*. Në kushtet aktuale, në burgun për të mitur nuk janë të ndarë personat e mitur dhe ata të moshës madhore.

Ajo që mund të konstatohet është se zgjidhjet tona ligjore, me të cilat burgju për të mitur përcaktohet sipas kriterit të kohës së kryerjes së veprës, e jo kohës së vuajtjes së dënimit, më saktë gjatë kohës së vuajtjes së dënimit, në të shumtën e rasteve, personi tanimë nuk është i mitur, por është person i ri i moshës madhore, e që nuk është në përputhje të plotë me Rregullat Evropiane të Burgjeve, të cilat në Nenin 24 e rregullojnë problematikën e personave të mitur. Rregullat Evropiane të Burgjeve e përdorin ekskluzivisht termin persona të mitur, me ç'rast përcaktohet se *“Të miturit e dënuar detyrimisht dënimin burgim për të mitur e vuajnë në institucion të veçantë për të mitur”*.

Ekipi i MPN-së konsideron se korniza ligjore duhet të harmonizohet me rregullat dhe standardet ndërkombëtare, me ç'rast gjithnjë duhet të kihet parasysh interesi më i mirë i fëmijës në procesin e risocializimit të tij.

**REKOMANDIMI nr. 34 – Të përforcohen procedurat për hetimin dhe ndëshkimin e çdo lloj sjelljeje të keqe nga ana e kuadrit policor, burgut dhe të gjyqësorit, përfshirë edhe përforcimin e rolit mbikëqyrës të Avokatit të Popullit (Republika Çeke).**

**Statusi: pranohet**

Nga ana e AP-së është paraqitur kërkesë për të iniciuar:

	PROCEDURË POLICORE			INSTITUCIONE NDËSHKUESE-KORREKTUESE		
	penale	disiplinore		penale	disiplinore	
2008	4		1			1
2009	2			1		1
2010				1		1
2011	1			1		1
2012	1					1

**Parashtrësia të parashtruara pranë AP-së**

Numri i përgjithshëm i parashtrësive për INK dhe EEK:  
2008 -55, 2009-347, 2010-395, 2011-352, 2012-278

Numri i përgjithshëm i parashtrësive kundër nëpunësve policorë:  
2008-67, 2009 – 252, 2010-238, 2011-180, 2012-220

Nga ana e MPN-së janë realizuar 50 vizita të rregullta dhe 15 për ri-kontroll.

Në vitin 2012 është nënshkruar Memorandumi për bashkëpunim me Shoqatën e Psikiatërve, ndërsa janë realizuar 9 vizita në vendet e privimit nga liria në shoqërinë e psikiatrit.

Nga puna me lëndë e AP-së u konstatua zvogëlim i numrit të parashtrësive për tejkalimin e autorizimeve policore, veçanërisht përdorimin e tepërt të forcës, por akoma ka raste të tejkalimit të autorizimeve.

**REKOMANDIMI nr. 35 – Të miratohen të gjitha masat e domosdoshme për sigurimin e lirisë së shprehjes dhe mbrojtjen e çfarëdo qoftë ndikimi mbi lirinë e shtypit (Zvicër).**

**Statusi: pranohet**

**REKOMANDIMI nr. 36 – Të monitorohet implementimi i legjislacionit që ka të bëjë me lirinë e besimit fetar, në mënyrë që të sigurohet përmbushje e plotë e lirisë së praktikimit të religjionit, nga ana e të gjitha bashkësive dhe grupeve fetare në shtet (Itali).**

**Statusi: pranohet**

**REKOMANDIMI nr. 37 – Implementimi i masave efektive për parandalimin e kërcënimeve ndaj votuesve në zgjedhjet e ardhshme (Irlandë); përpilimi i listës së re të zgjedhësve në mënyrë që të sigurohet pjesëmarrje e plotë e trupit votues në zgjedhjet e ardhshme (Irlandë).**

**Statusi: pranohet**

REKOMANDIMI nr. 38 – Të ndërmerren hapa për t'u siguruar se të gjitha pengesat e tjera në punën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut mënjanohen shpejtë, kështu që ata të mund të funksionojnë në një mjedis transparent dhe të sigurt (Irlandë).

*Statusi: pranohet*

REKOMANDIMI nr. 39 – Të përcaktohet se deri në cilën shkallë, pronarët e mediave përpiqen të ndikojnë mbi gazetarët dhe të miratohen masa përkatëse për parandalimin e ndërhyrjes së interesave private në gazetari (Norvegji).

*Statusi: pranohet*

REKOMANDIMI nr. 40 – Të miratohen dispozita për adresimin e fenomenit të çregjistrimit nga shkolla të fëmijëve romë dhe fëmijëve të cilët jetojnë në mjedise rurale, veçanërisht vajzave (Alzhir); të vazhdohet me angazhimet për garantimin e arsimit falas në nivel fillor për të gjithë fëmijët, me theks të veçantë për grupet minoritare (Vatikan); të vazhdohet me përkushtim të veçantë drejt qasjes në arsim të të gjithë fëmijëve, pavarësisht prejardhjes së tyre etnike, si dhe në të gjitha nivelet arsimore, parashkolllore, fillore dhe të mesme (Belgjikë).

*Statusi: pranohet*

REKOMANDIMI nr. 41 – Të vazhdojnë përpjekjet në drejtim të sigurimit që minoriteti rom, shqiptar dhe minoritetet e tjera të kenë qasje për strehim, punësim, arsim dhe mbrojtje shëndetësore përkatëse dhe se do të do t'i kushtohet vëmendje më e madhe promovimit të integritetit të kësaj popullate në të gjitha fushat e jetës shoqërore, pa diskriminim (Alzhir); të vazhdohet me miratimin e masave për gjendjen e grave nga mjediset rurale, të cilat u takojnë minoriteteve etnike, para së gjithash romëve dhe shqiptarëve (Argjentinë); të sigurohet implementim i legjislacionit relevant, kryesisht i ligjeve të cilët kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve dhe atyre të cilët synojnë përmirësimin e kushteve jetësore të romëve (Zvicër); në mënyrë efektive të mbështeten organizatat e përbashkëta etnike në lidhje me interesat e përgjithshme qytetare, profesionale dhe interesat afariste, me qëllim që tërësisht të mbështetet kohezioni shoqëror i të gjitha grupeve etnike (Austri); të sigurohet implementim i shpejtë i masave për Strategjinë Nacionale të Romëve (Austri); harmonizim me Strategjinë dhe Dekadën e Romëve, e cila do të përfundojë në vitin 2015 (Brazil); të implementohet Strategjia e Romëve dhe planet e veprimit, në përputhje me Strategjinë e Dekadës së Romëve 2005-2015 (Kanada); të sigurohet qasje e barabartë dhe papengesë deri te mbrojtja shëndetësore e romëve (Austri); të mbështetet përdorimi, nga ana e romëve, i të drejtave të tyre ekonomike, sociale dhe kulturore, kryesisht përmes implementimit të programeve për lehtësimin e regjistrimit të lindjeve dhe lëshimin e dokumenteve për identifikim të kësaj pjese të popullatës (Meksikë); nga Agjencia për të Drejtat e Grupeve Etnike të sigurohen resurset e domosdoshme për përballjen efektive me problemet për etnitetet të cilat janë më pak se 20% e popullsisë, (Irlandë); të përmirësohet gjendja e përfshirjes së disa grupeve etnike, kryesisht rome, të cilët shpeshherë përballen me situata të mungesës së mbrojtjes (Spanjë); fokusim në drejtim të më shumë resurseve për përfshirjen e etniteteve në arsimimin e fëmijëve të moshës shkolllore, për kultivimin e tolerancës dhe respektimin e diversiteteve të gjeneratave të ardhshme (SHBA).

*Statusi: pranohet*

REKOMANDIMI nr. 42 – Të arrihen në mënyrë progresive objektivat për të drejtat e njeriut të dhëna nga Këshilli për të Drejtat e Njeriut 9/12 (Brazil).

*Statusi: pranohet*